



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 553/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25/08/2015 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për s’kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë Cara” sh.p.k & “Neal-86” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me objekt: “*Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare Toshkëz, Komuna Allkaj*”, me fond limit 32,081,296 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.05. 2015 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: BO “Cara” sh.p.k & “Neal-86” sh.p.k.

*Adresa: Rr “Asim Vokshi”, Nd.14 H.6 Ap.15, kutia postare 1016
Tiranë*

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

*Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, Nr.10
Tiranë*

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:


I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i Operatorëve ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor;



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2015 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Rikonstrukcion i shkollës 9- vjeçare Toshkëz, Komuna Allkaj”, me fond limit loti 32,081,296 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.05. 2015 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2 . Në datën 13.05.2015 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 22.06.2015, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

BO “Kola” sh.p.k & “Kupa” sh.p.k	17,878,254	Lekë;	i s’kualifikuar;
BO “Jogi” sh.p.k & “Biba X” sh.p.k	19,016,256	Lekë;	i kualifikuar;
“Derveni 1” sh.p.k	19,915,468	Lekë;	i s’kualifikuar;
BO “Spektri” sh.p.k & “Beqiri” sh.p.k	20,309,898	Lekë;	i s’kualifikuar;

BO "Cara" sh.p.k & "Neal 86" sh.p.k	20,548,148	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Alba Konstruksion" sh.p.k.	21,220,557	Lekë	i s'kualifikuar;
BO "Fled" sh.p.k & "Shkelqimi 07" sh.p.k	21,364,496	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Avduli" sh.p.k	21,449,152	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Kevin" sh.p.k	21,499,497	Lekë;	i kualifikuar;
BO "Erges" sh.p.k & "England" sh.p.k	22,087,952	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Shendelli" sh.p.k	22,136,621	Lekë;	i kualifikuar;
BO "Sireta 2F" sh.p.k & "Murati" sh.p.k	22,222,222	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Eral Konstruksion" sh.p.k	22,395,028	Lekë;	i kualifikuar ;
BO "Harmonia" & "Blerimi" & "Ste-La 2000" shpk	22,447,080	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Filipi" & "Aluera" & "Viko" sh.p.k.	23,390,265	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Be-Is" sh.p.k.	23,829,051	Lekë;	i kualifikuar;
"Aurora" sh.p.k.	23,876,556	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Bajrami N" shpk	23,901,173	Lekë;	i kualifikuar;
"Company Riviera 2008" sh.p.k.	24,122,690	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Llazo" sh.p.k.	24,562,264	Lekë;	i kualifikuar;
"B-93" sh.p.k.	24,973,667	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Kombeas" sh.p.k.	25,182,868	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Shamo Konstruksion" sh.p.k.	25,694,850	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Junik" sh.p.k.	26,606,193	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Salillari" sh.p.k.	29,085,163	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Beladi" sh.p.k.	29,821,798	Lekë;	i s'kualifikuar;

II.4. Në datën 22.06.2015 Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Cara" sh.p.k & "Neal-86" sh.p.k. . është njoftuar përmes S.P.E për s'kualifikimin e ofertës nga procedura e mësipërme e prokurimit me argumentin se *"Nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentet e Tenderit, shtojca 10 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", pika 2.1 gërma "e" ku është kërkuar: Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjithë detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Operatori "Neal 86" sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimet për muajin mars 2015, detyrim ky i maturuar ditën e hapjes së ofertave. Për arsye se mospërmbushja e një kriteri të vetëm të përcaktuar në Dokumentet e Tenderit përbën kusht për mos kualifikimin e ofertuesve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi që mos të vazhdojë me shqyrtimin e pjesës së mbetur të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomikë në këtë procedurë prokurimi."*

II.5.Nga iformacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit rezulton se operatorë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për vlerësimin e mësipërim.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes "Cara" sh.p.k & "Neal-86" sh.p.k. nuk kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 10.07.2015, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi duke njoftuar operatorët ekonomikë ofertues përmes S.P.E si më poshtë vijon:

BO "Kola" sh.p.k & "Kupa" sh.p.k	17,878,254	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Jogi" sh.p.k & "Biba X" sh.p.k	19,016,256	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Derveni 1" sh.p.k	19,915,468	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Spektri" sh.p.k & "Beqiri" sh.p.k	20,309,898	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Cara" sh.p.k & "Neal 86" sh.p.k	20,548,148	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Alba Konstruksion" sh.p.k.	21,220,557	Lekë	i s'kualifikuar;
BO "Fled" sh.p.k & "Shkelqimi 07" sh.p.k	21,364,496	Lekë;	i kualifikuar;
"Avduli" sh.p.k	21,449,152	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Kevin" sh.p.k	21,499,497	Lekë;	i kualifikuar;
BO "Erges" sh.p.k & "England" sh.p.k	22,087,952	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Shendelli" sh.p.k	22,136,621	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Sireta 2F" sh.p.k & "Murati" sh.p.k	22,222,222	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Eral Konstruksion" sh.p.k	22,395,028	Lekë;	i kualifikuar ;
BO "Harmonia" & "Blerimi" & "Ste-La 2000" shpk	22,447,080	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Filipi" & "Aluera" & "Viko" sh.p.k.	23,390,265	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Be-Is" sh.p.k.	23,829,051	Lekë;	i kualifikuar;
"Aurora" sh.p.k.	23,876,556	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Bajrami N" shpk	23,901,173	Lekë;	i kualifikuar;
"Company Riviera 2008" sh.p.k.	24,122,690	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Llazo" sh.p.k.	24,562,264	Lekë;	i s'kualifikuar;
"B-93" sh.p.k.	24,973,667	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Kombeas" sh.p.k.	25,182,868	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Shamo Konstruksion" sh.p.k.	25,694,850	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Junik" sh.p.k.	26,606,193	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Salillari" sh.p.k.	29,085,163	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Beladi" sh.p.k.	29,821,798	Lekë;	i s'kualifikuar;

II.7. Në datën 15.07.2015 pala ankimuese ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke ngritur pretendimet se: "*[...] Referuar mënyrës së s'kualifikimit nuk jemi dakord me vlerësimin e KVO-së për arsye se vërtetimi i energjisë nga OSHEE për shoqërinë "Neal-86" sh.p.k. është i rregullt dhe data kur është lëshuar më 17.04.2015 vërteton 0 lekë detyrimë për faturat e energjisë elektrike. Vërtetimi është brenda afatit mujor dhe për më tej nuk ka nevojë për interpretime. Për dijeni OSHEE nuk lëshon vërtetime po pati detyrime. Kërkojmë riklasifikim dhe kualifikimin e shoqërisë tonë.[...]*"

II.8. Në datën 27.07.2015 autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues me argumentin se "*[...] Nuk ka respektuar afatet ligjore për paraqitjen e ankesës pranë Autoritetit Kontraktor të përcaktuar në nenin 63 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar [...]*".

II.9. Në datën 31.07.2015 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.10. Në datën 05.08.2015 përmes shkresës nr.1557/2 datë 05.08.2015 dhe në datën 11.08.2015 përmes shkresës nr.1557/5 datë 10.08.2015 autoriteti kontraktor, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Nga informacioni dorëzuar nga autoriteti kontraktor dhe vertifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

Në datën 13.05.2015 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

Në datën 22.06.2015, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

BO "Kola" sh.p.k & "Kupa" sh.p.k	17,878,254	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Jogi" sh.p.k & "Biba X" sh.p.k	19,016,256	Lekë;	i kualifikuar;
"Derveni 1" sh.p.k	19,915,468	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Spektri" sh.p.k & "Beqiri" sh.p.k	20,309,898	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Cara" sh.p.k & "Neal 86" sh.p.k	20,548,148	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Alba Konstruksion" sh.p.k.	21,220,557	Lekë	i s'kualifikuar;
BO "Fled" sh.p.k & "Shkelqimi 07" sh.p.k	21,364,496	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Avduli" sh.p.k	21,449,152	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Kevin" sh.p.k	21,499,497	Lekë;	i kualifikuar;
BO "Erges" sh.p.k & "England" sh.p.k	22,087,952	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Shendelli" sh.p.k	22,136,621	Lekë;	i kualifikuar;
BO "Sireta 2F" sh.p.k & "Murati" sh.p.k	22,222,222	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Eral Konstruksion" sh.p.k	22,395,028	Lekë;	i kualifikuar ;
BO "Harmonia" & "Blerimi" & "Ste-La 2000" shpk	22,447,080	Lekë;	i s'kualifikuar;
BO "Filipi" & "Aluera" & "Viko" sh.p.k.	23,390,265	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Be-Is" sh.p.k.	23,829,051	Lekë;	i kualifikuar;
"Aurora" sh.p.k.	23,876,556	Lekë;	i s'kualifikuar;
"Bajrami N" shpk	23,901,173	Lekë;	i kualifikuar;
"Company Riviera 2008" sh.p.k.	24,122,690	Lekë;	i s'kualifikuar;

“Llazo” sh.p.k.	24,562,264	Lekë;	i kualifikuar;
“B-93” sh.p.k.	24,973,667	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Kombeas” sh.p.k.	25,182,868	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Shamo Konstruksion” sh.p.k.	25,694,850	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Junik” sh.p.k.	26,606,193	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Salillari” sh.p.k.	29,085,163	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Beladi” sh.p.k.	29,821,798	Lekë;	i s’kualifikuar;

Në datën 22.06.2015 Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Cara” sh.p.k & “Neal-86” sh.p.k. . është njoftuar përmes S.P.E për s’kualifikimin e ofertës nga procedura e mësipërme e prokurimit me argumentin se *“Nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentet e Tenderit, shtojca 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1 gërma “e” ku është kërkuar: Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjithë detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Operatori “Neal 86” sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimet për muajin mars 2015, detyrim ky i maturuar ditën e hapjes së ofertave. Për arsye se mospërmbushja e një kriteri të vetëm të përcaktuar në Dokumentet e Tenderit përbën kusht për mos kualifikimin e ofertuesve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi që mos të vazhdojë me shqyrtimin e pjesës së mbetur të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.”*

Në datën 10.07.2015, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi duke njoftuar operatorët ekonomikë ofertues përmes S.P.E si më poshtë vijon:

BO “Kola” sh.p.k & “Kupa” sh.p.k	17,878,254	Lekë;	i s’kualifikuar;
BO “Jogi” sh.p.k & “Biba X” sh.p.k	19,016,256	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Derveni 1” sh.p.k	19,915,468	Lekë;	i s’kualifikuar;
BO “Spektri” sh.p.k & “Beqiri” sh.p.k	20,309,898	Lekë;	i s’kualifikuar;
BO “Cara” sh.p.k & “Neal 86” sh.p.k	20,548,148	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Alba Konstruksion” sh.p.k.	21,220,557	Lekë	i s’kualifikuar;
BO “Fled” sh.p.k & “Shkelqimi 07” sh.p.k	21,364,496	Lekë;	i kualifikuar;
“Avduli” sh.p.k	21,449,152	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Kevin” sh.p.k	21,499,497	Lekë;	i kualifikuar;
BO “Erges” sh.p.k & “England” sh.p.k	22,087,952	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Shendelli” sh.p.k	22,136,621	Lekë;	i s’kualifikuar;
BO “Sireta 2F” sh.p.k & “Murati” sh.p.k	22,222,222	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Eral Konstruksion” sh.p.k	22,395,028	Lekë;	i kualifikuar ;
BO “Harmonia” & “Blerimi” & “Ste-La 2000” shpk	22,447,080	Lekë;	i s’kualifikuar;
BO “Filipi ” & “Aluera” & “Viko” sh.p.k.	23,390,265	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Be-Is” sh.p.k.	23,829,051	Lekë;	i kualifikuar;
“Aurora” sh.p.k.	23,876,556	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Bajrami N” shpk	23,901,173	Lekë;	i kualifikuar;
“Company Riviera 2008” sh.p.k.	24,122,690	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Llazo” sh.p.k.	24,562,264	Lekë;	i s’kualifikuar;
“B-93” sh.p.k.	24,973,667	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Kombeas” sh.p.k.	25,182,868	Lekë;	i s’kualifikuar;

“Shamo Konstruksion” sh.p.k.	25,694,850	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Junik” sh.p.k.	26,606,193	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Salillari” sh.p.k.	29,085,163	Lekë;	i s’kualifikuar;
“Beladi” sh.p.k.	29,821,798	Lekë;	i s’kualifikuar;

Në datën 15.07.2015 pala ankimuese ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke ngritur pretendimet se: “ [...] Referuar mënyrës së s’kualifikimit nuk jemi dakord me vlerësimin e KVO-së për arsye se vërtetimi i energjisë nga OSHEE për shoqërinë “Neal-86” sh.p.k. është i rregullt dhe data kur është lëshuar më 17.04.2015 vërteton 0 lekë detyrimë për faturat e energjisë elektrike. Vërtetimi është brenda afatit mujor dhe për më tej nuk ka nevojë për interpretime. Për dijeni OSHEE nuk lëshon vërtetime po pati detyrime. Kërkojmë riklasifikim dhe kualifikimin e shoqërisë tonë.[...]”

III.2. KPP sjell në vëmendje se në nenin 63, pika 2, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”. Pala ankimuese është vënë në dijeni fillimisht në datën 22.06.2015 për arsyet e s’kualifikimit të ofertës së saj nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Nga data e vënies në dijeni për herë të parë të palës ankimuese për s’kualifikimin e ofertës së saj ka filluar edhe llogaritja e afateve të ankimit. Pala ankimuese brenda afateve të parashikuara nga *lex specialis* nuk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik për arsyet e s’kualifikimit të ofertës së saj. Fakti që autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim në S.P.E. nuk legjitimon palën ankimuese të paraqesë një ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 15.07.2015 për shkaqet e s’kualifikimit të njohura që në datën 22.06.2015. Llogaritja e afateve ligjore për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis që në momentin e parë kur operatorët ekonomikë marrin dijeni për vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Rivlerësimi i kryer në S.P.E nuk ka ndryshuar thelbin e s’kualifikimit të operatorit ekonomik ankimues. Gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues është vendosur që me vendimin e KVO-së së datës 22.06.2015.

III.3. Shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit (Nëse kërkesa përmbush elementet formale, Komisioni vazhdon me shqyrtimin në themel të saj), në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk përmbush elementet formale për faj të vetë ankimuesit, pasi nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar të shterimit të ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik ankimues megjithëse ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor një ankesë të hartuar në formën e përcaktuar në ligj nuk legjitimohet të paraqesë ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mos ezaurimit të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit 7 ditor të parashikuara nga neni 63 pika 2 e LPP-së.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e BO “Cara” sh.p.k & “Neal-86” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Rikonstruktion i shkollës 9- vjeçare Toshkëz, Komuna Allkaj”, me fond limit 32,081,296 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.05. 2015 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1344 Protokolli; Datë 31.07.2015



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar Anëtar
Leonard Gremshi Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri